REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 10.10.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj.

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Çështja për të cilën do vijojmë diskutimin ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). Klodi, fjala për ty.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, po parashtroj relacionin e radhës të dërguar në mbledhjen e sotshme që ka për objekt projektvendimin "Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura".

Me Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka 6 gjyqtarë, ku aktualisht ushtrojnë detyrën 2 (dy)

gjyqtarë: znj. {...} me emërim të përhershëm, ndërsa z. {...} me transferim të përkohshëm me pëlqim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}deri më 24.01.2023.

Në tabelën që është inkorporuar relacionit, situata në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke pasqyruar edhe ngarkesën e gjyqtarëve është si më poshtë: znj. {...}, ngarkesa e saj është me 240 çështje; znj. {...} është shkarkuar me vendimin e KPK-së, vendim i datës 26.09.2022 dhe ka pasur deri në atë kohë kur ushtronte funksionin e gjyqtarit, 159 dosje; gjyqtari {...} është përfshirë në skemën e delegimit me vendimin nr. 225, datë 20.06.2022, deri në 20.06.2023; gjyqtare {...} është shkarkuar nga KPK-ja me vendimin nr. 421, datë 13.07.2021; gjyqtare {...} është komanduar pranë ILD-së me vendimin nr. 333, datë 17.09.2020; gjyqtari {...} është shkarkuar me vendim të KPK-së me nr. 530, datë 10.05.2022; ndërsa gjyqtari i transferuar me pëlqimin e tij z. {...} është transferuar me pëlqim me vendimin nr. 16, datë 17.01.2022, deri në datën 24.01.2023, ka gjithsej si ngarkesë pune 174 dosje.

Me vendimin nr. 333, datë 17.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur ndër të tjera: "Zgjatja e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, deri në përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ajo ka kandiduar".

Me Vendimin nr. {...}, datë 13.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur ndër të tjera "Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}".

Me Vendimin nr. {...}, datë 10.05.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur ndër të tjera "Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Gjirokastër..."

Me Vendimin e datës 26.09.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur ndër të tjera "Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Gjirokastër..."

Me vendimin nr. 225, datë 20.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur ndër të tjera: "Caktimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1 (një) vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave" dhe me vendimin nr.226 ai është caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër

informohemi se numri i çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë, e shpërndarë midis gjyqtareve është përkatësisht si më poshtë:

-Gjyqtare {...}, 242 çështjeje;

-Gjyqtar {...}, 174 çështje;

-Gjyqtare {...}, kishte në shqyrtim 159 çështje.

Nga të cilat 14 (katërmbëdhjetë) çështje, 11 penale dhe 3 civile gjykohen me trup gjykues me 3 (tre) gjyqtarë.

Në këto kushte rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, aktualisht ka pozicione të lira të përkohshme. Vlen të ritheksohet se afati i transferimit të përkohshëm për z. {...} përfundon në datë 24.01.2023.

Bazuar në të dhënat sa sipër, rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër të klasifikohet si "gjykatë në nevojë", në kuptim të shkronjës "a", pika 2, neni 3, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit", miratuar me Vendimin nr.23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite: "... a) "Gjykatë në nevojë" nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj".

Në situatën që ndodhet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër Komisioni vlerëson se adresimi i nevojave të saj mund të bëhet përmes transferimit të përkohshëm të një gjyqtari. Për këtë mbahet në konsideratë edhe komunikimi elektronik i Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 27.09.2022.

Sa i përket hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në rastin konkret, Komisioni vlerëson se ekzistojnë dy kushtet që lejojnë atë, përcaktuar ato në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016, sikundër edhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Konkretisht, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: "1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. ...".

Kurse në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, përcaktohet se: “1. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit. 2. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm”.

Duke iu referuar rastit konkret, konstatojmë se në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, pasi të 11 gjyqtarët e komanduar tashmë në skemën e delegimit, për shkak të nevojave imediate në pikëpamje të funksionalitetit të disa gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, janë caktuar për të gjykuar për një periudhë 1-vjeçare pranë këtyre gjykatave. Konkretisht, gjyqtarët e skemës së delegimit: z. {...} dhe znj. {...} janë caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë; z. {...} dhe z. {...} janë caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës; z. {...} dhe znj. {...} janë caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë; z. {...} i cili është caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër; z. {...} caktuar për të gjykuar për llogari të gjykatës së apelit Gjirokastër; z.{...} caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit; znj. {...} dhe znj. {...}, të cilët janë caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për rrjedhojë, nevojat e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit.

Në vijim, sikurse u përmend, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka aktualisht një pozicion të lirë të përkohshëm.

Vlen të përmendet se nevojat e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nuk mund të adresohen as nëpërmjet masave të tjera, sikundër janë ato të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, mbasi sipas këtij vendimi, mundësohet caktimi i gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçantë vetëm në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate për gjykimin e tyre. Në rastin konkret nevoja është për gjykimin në vijimësi të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pra për një periudhë të caktuar kohe dhe jo për

çështje gjyqësore të veçanta. Lidhur me këtë moment mbahet parasysh rregullimi i pikës 2, të nenit 5, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, sipas të cilit: "Këshilli shtyn shpalljen e vendeve të lira për transferim kur çmon se nevoja në gjykatën në të cilën synohet transferimi nuk është emergjente. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera për adresimin e nevojës në gjykatën në të cilën synohet transferimi".

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se për plotësimin e nevojave që paraqet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, duke hapur kryesisht procedurën e transferimit të përkohshëm në pozicionin e lirë të përkohshëm pranë kësaj gjykate, sikundër përcaktohet në pikën 1, të nenit 5, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, sipas të cilit: "Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, mbi kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozim të Komisionit te Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin".

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin "Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura".

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në dy Krerë dhe 10 pika.

Kreu I i projektvendimit bën fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Në pikën 1, të Kreut të parë të projektvendimit, përcaktohet hapja e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Më tej, në pikën 2, të këtij Kreu të projektvendimit, përcaktohet shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për një pozicion të lirë.

Në pikën 3, të këtij Kreu, përcaktohet afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm, i cili mbetet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të

projektvendimit. Sa i përket afatit të kandidimit, në nenin 46 të Ligjit për Statusin nuk përcaktohet një afat konkret, ndaj, për analogji me afatet e përcaktuara nga ligji për procedura të tjera kandidimi, Këshilli duhet të konsiderojë një afat optimal që të sigurojë njohjen e gjyqtarëve për vendimin e Këshillit dhe mundësinë për ata për të kandiduar, ku si i tillë mund të konsiderohet një afat 7-10 ditë.

Ne propozojmë se afati i dorëzimit të kërkesave të bëhet deri më datë 17.10.2022, pra duke i lënë një afat 7-ditor. Sot jemi me datë 10, deri më datë 17 ne mendojmë se është afati optimal i mjaftueshëm për të gjithë kandidatët për të paraqitur kërkesën e tyre për transferim të përkohshëm me pëlqim.

Në pikën 4, të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që kandidati duhet të paraqesë në momentin e aplikimit dhe konkretisht: a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail); c) Fotokopjen e kartës së identitetit; ç) Deklaratën "Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm" sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi; d) Vetëdeklarimin për mospasjen masë disiplinore në fuqi; dh) Vetëdeklarimin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi.

Së fundi, në pikën 5, të këtij Kreu të projektvendimit, përcaktohet vendi i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidat, pikërisht në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun II të projektvendimit jepet informacioni për kriteret dhe kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim.

Në pikën 6, të këtij Kreu të projektvendimit përcaktohen kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim dhe konkretisht: a) Transferimi i përkohshëm nuk duhet të cenojë funksionalitetin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm; b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm; c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemën e delegimit; ç) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të

transferimit të përkohshëm; d) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016.

Më tej, në pikën 7, të këtij Kreu të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim, pikërisht deri në një vit, si dhe se ky transferim mund të përsëritet.

Në pikën 8, të këtij Kreu të projektvendimit, përcaktohen rastet e përfundimit para afatit të kohëzgjatjes së transferimit të përkohshëm me pëlqim dhe konkretisht: a) me kërkesë të gjyqtarit të transferuar përkohësisht, për shkaqe të justifikuara; b) kur vazhdimi i transferimit të përkohshëm do të passillte cenim të funksionimit të gjykatës ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm; c) kur dobia e transferimit të përkohshëm është më e vogël se efekti negativ i shkaktuar në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm; ç) kur ndaj gjyqtarit të transferuar përkohësisht merret masë disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të tij; d) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit; dh) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht largohet nga detyra.

Kurse në pikën 9 të projektvendimit përcaktohet se për shqyrtimin e kërkesave për transferim të përkohshëm me pëlqim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek procedurën e përcaktuar në Vendimin e tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar.

Në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 10, përcaktohet se transferimi i përkohshëm me pëlqim i gjyqtarit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet edhe hyrja në fuqi e tij, që është pikërisht menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur relacionit përkatës gjenden, përtej projektvendimit të parashikuar, gjenden të inkorporuara edhe deklaratat përkatëse: deklarata e parë për pëlqimin për transferim të përkohshëm; vetëdeklarimi për masë disiplinore; vetëdeklarimi për situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin.

Brikena Ukperaj: Zonja Kryetare, mund të marrë fjalën?

Naureda Llagami: Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Jam dakord me përmbajtjen e projekt-aktit dhe me nevojën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Kam vetëm një propozim lidhur me pikën 7 të projekt-aktit. Mos ndoshta duhet të përcaktojmë datën, kohëzgjatjen e transferimit deri në datën 01.05.2022 *(2023)*, datë kur hyn në fuqi harta e re gjyqësore për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe jo të përcaktojmë afatin deri në një 1 vit? Duke marrë parasysh edhe praktikën që kemi mbajtur për transferimet e tjera. Pra në pikën 7 është parashikuar që zgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në 1 vit. Ky transferim mund të përsëritet. Me hartën e re gjyqësore do të ndodhë riorganizimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, bashkohen të dy gjykatat dhe do shkojnë gjyqtarët. Parimisht, sipas ligjit, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet duhet të akomodohen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ndoshta kjo gjë do ta zgjidhë disi situatën që ndodhet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Me qëllim që të mos kemi vijueshmëri të transferimit, do të ishte mirë që kjo datë të ishte data deri kur mundet të përcaktohej kohëzgjatja e transferimit me pëlqim, i cili në eventualitetin që nuk do të kemi pëlqim, patjetër që do shkojë në transferim pa pëlqim. Pra t'i paraprijmë datës. Megjithatë, ky ishte një vlerësim nga ana ime.

Klodian Kurushi: Mund të jap një shpjegim për këtë pjesën e fundit?

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet e cila me hartën e re do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, aktualisht në detyrë ka dy gjyqtarë, njëra prej të cilave ka paraqitur një kërkesë për të mos u caktuar në skemën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për shkak se ajo është në pritje të marrjes së lejes së shtatzënisë. Kështu që edhe në eventualitetin e bashkimit të këtyre gjykatave Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet do të sjellë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër një gjyqtar efektiv dhe kam përshtypjen se sjellja e një gjyqtari efektiv do ta bëjë përsëri

të pamundur ndarjen në mënyrë të barabartë të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Pra është e pamjaftueshme që ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, edhe me ardhjen e gjyqtares nga Përmeti që do sjellë të gjitha dosjet e regjistruara dhe të gjykuara aktualisht në Gjykatën e Përmetit, do të jetë joproporcionale, jo e drejtë dhe e pamundur për t'u evaduar në kohën dhe në afatin e arsyeshëm nga gjyqtarët aktualë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ndodhur në këto kushte mendojmë që propozimi i bërë për afatin 1-vjeçar mendoj që mund të jetë më i arsyeshëm për rastin konkret.

Brikena Ukperaj: Klodi, më fal!

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet në fakt ka në organikën e saj 4 gjyqtarë, por ka 3 efektivë, nga të cilët 1 e kemi transferuar në Gjirokastër. Gjyqtarët që do shkojnë në Gjirokastër nuk janë 1, por janë 2. Gjyqtarja {...} ka kërkuar të përjashtohet nga skema e delegimit, pra nga skema e caktimit në gjykata të tjera, por kjo nuk do të thotë që ajo nuk do të shkojë në Gjirokastër. Pra numri i gjyqtarëve që shkojnë në Gjirokastër janë 2, dhe 2 të tjerë, shkojmë në 4 gjyqtarë. Mendoj që me ngarkesën që ka Gjykata e Gjirokastrës dhe me numrin shumë të vogël të çështjeve të reja që shkojnë nga Gjykata e Përmetit në Gjykatën e Gjirokastrës, efektiviteti i gjykatës, disi të themi, sepse ndoshta nuk e dimë akoma numrin që do të ketë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, do të përmirësohet. Nuk mund të llogarisim vetëm 1 gjyqtar, janë 2 që shkojnë në Gjirokastër. Megjithatë, diskutimi im ishte që nëse ky transferimi ynë me pëlqim nuk do të kemi asnjë pëlqim nga ana e gjyqtarëve, do të kthehet në një transferim pa pëlqim, ku zbatojmë rregullat për të çuar pa pëlqim gjyqtarin më të ri në përvojë profesionale (ose ai që ka përvojën profesionale më pak në gjykatë). Në momentin që do të kthehet në një transferim pa pëlqim, detyrimisht siç kemi bërë për të tjerat, ky transferim do të zgjatet deri në momentin e hyrjes së hartës gjyqësore. Prandaj dhe bëra të gjithë diskutimin, deri në datën 01.05.2022 *(2023)* është një afat optimal dhe i arsyeshëm për kohëzgjatjen e transferimit. Megjithatë është Këshilli që e vendos. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Edhe një sqarim të vogël.

Mbase s'e kuptova mirë. Unë thashë, për gjyqtaren {...} kam përshtypjen se do

marri gjatë kësaj kohe një leje të zakonshme. Domethënë, ajo do vazhdojë funksionin si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Përmet, por kam përshtypjen që së shpejti ajo mund të marri lejen e zakonshme. Në këtë pikë, gjyqtarja që do vihet në dispozicion pas bashkimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet me atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, efektivisht do jetë vetëm 1 gjyqtare, e cila, në vlerësimin tim, derisa bëhet ky bashkim, do marri të gjitha dosjet që ajo aktualisht do t'i gjykojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Prandaj kjo është arsyeja pse kemi vënë këtë datë që mendoj që është më e përshtatshme.

Brikena Ukperaj: Nuk e kuptova. Çfarë leje të zakonshme do marri gjyqtarja?

{...} ka kërkuar të përjashtohet nga caktimi në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin. Ajo do vazhdojë ta ushtrojë funksionin.

Klodian Kurushi: Në informacionin që kemi marrë neve, kam përshtypjen se {...} do marri lejen e barrë lindjes.

Brikena Ukperaj: Do marri leje barrë lindjeje gjyqtarja? Njëra nga gjyqtaret?

Klodian Kurushi: Po, po!

Brikena Ukperaj: Do shkojnë 4 gjyqtarë.

Më falni se ndoshta nuk u dëgjova.

Unë propozoj që në pikën 7 të përcaktohet si kohëzgjatje e transferimit data 01.05.2022 *(2023)*.

Faleminderit!

Marçela Shehu: Më fal, vetëm një koment të shkurtër.

Kam përshtypjen që ajo që propozon Brikena sot në mbledhje lidhur me kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm, tashmë është konsoliduar me vendim nga Këshilli. Pra Këshilli ka një standard, në mos gabohem, në rastin e transferimit në Gjykatën Administrative Durrës (më korrigjoni nëse jam gabim), ku Këshilli vendosi që

afati i transferimit të përkohshëm do të ishte deri në datën kur hynte në fuqi vendimi përkatës për riorganizimin e gjykatave. Kështu që, në qoftë se Këshilli e ka mbajtur qëndrimin në atë vendim lidhur me kohëzgjatjen e transferimit, atëherë bën sens që ne të ndjekim të njëjtin standard në momentin që do të shpallim hapjen e procedurës së transferimit edhe për Gjykatën e Gjirokastrës.

Alban Toro: Më fal Marçela, specifika e problemit në fjalë është se një nga gjyqtaret e Përmetit nuk do të ketë mundësi të ushtrojë detyrën për një kohëzgjatje të madhe. Që do të thotë, nuk na zgjidh problemet edhe bashkimi. Natyrisht, në çdo moment, Këshilli, nëse e shikon të arsyeshme, e ndërpret në çdo kohë transferimin sepse e ka këtë oportunitet, dhe çdo gjë vijon si më parë. Fakti që kemi zgjedhur këtë përjashtim, do të thotë vetëm për efekt të parashikimit që gjyqtarja e Përmetit nuk do të mund të ushtrojë detyrën për një kohëzgjatje të madhe dhe nuk do të zgjidhë problemet e Gjykatës Gjirokastër.

Marçela Shehu: Unë kam përshtypjen që standardi që vendosi Këshilli në rastet e mëparshme lidhet me momentin juridik të fillimit të funksionimit të gjykatave të riorganizuara, pra jo me arsyet specifike të gjyqtarëve. Pra nëse Këshilli ka vendosur që periudha e transferimit për Gjykatën Administrative Durrës do të jetë deri në datën që do të fillojë puna në gjykatat e riorganizuara, atëherë i njëjti standard duhet të ndiqet.

Alban Toro: Prandaj edhe unë të evidentova faktin që ne atë standard e kemi ruajtur sepse mendojmë që me bashkimin e gjykatave do zgjidhim problemet e burimeve njerëzore. Në rastin konkret ky problem nuk zgjidhet me bashkimin sepse një nga gjyqtaret nuk do të jetë midis trupës gjyqësore për një kohë të gjatë dhe problemet e Gjirokastrës do vijojnë edhe pas bashkimit. Kështu që ne e kemi dhënë oportunitet Këshillit që në çdo moment, nëse e gjykon në të ardhmen që do të ketë një problem apo s'do ketë probleme me ngarkesën e çështjeve gjyqësore, do reagojë dhe e ndërpret transferimin dhe çdo gjë shkon si më parë. Kjo është pjesa specifike, që gjyqtarja e Përmetit nuk do të mund të ushtrojë detyrën për një kohë të gjatë.

Brikena Ukperaj: Alban, me të njëjtën logjikë ne mund të themi që në momentin që hyn në fuqi harta gjyqësore, do rivlerësojmë kërkesat dhe ngarkesën e gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastër, e cila ndryshon edhe emërtim, dhe nëse shohim që aty vërtetë ka nevojë për transferim tjetër, mund të shpallim një procedurë tjetër transferimi. E dyta, ne nuk e dimë, është një fakt që nuk dihet, a do ta marrë lejen? Sa do bëjë? Gjyqtarët kanë marrë dy muaj, kanë bërë tre muaj, mund ta bëjë të plotë, mund të mos e bëjë fare. Këtë gjë nuk e dimë se çfarë do të ndodhë. Prandaj, për të mbajtur të njëjtin standard, sepse edhe tek Gjykata Administrative Durrës ishte transferim me pëlqim, nuk ishte transferim pa pëlqim. Edhe tek Gjykata e Kavajës ishte transferim me pëlqim. Datën e përcaktuar e lamë datën e hyrjes në fuqi të hartës gjyqësore. Ndoshta këto gjykata kanë një ngarkesë shumë herë më të madhe se Gjykata e Gjirokastrës.

Alban Toro: Atë që nuk kuptoj, pse duhet t'i krijojmë vetes pengesa, kur në çdo moment, nëse përmirësohet situata, e ndërpret transferimin dhe askush nuk ngarkohet më me detyra të cilat duhet t'i kryejë dikush tjetër. Kurse ne, në momentin që në maj shikojmë prapë që nuk do të zgjidhet problemi, do jemi të detyruar prapë të hapim një shpallje tjetër, me pëlqim apo pa pëlqim, sepse do evidentohet fakti që ajo nuk do të kthehet më në punë. Pra në çdo moment ne e kemi këtë oportunitet për të reaguar në përputhje me dëshirën e gjyqtares. Nëse kthehet në punë, ne ndërpresim transferimin; nëse s'kthehet në punë, transferimi vijon sipas afatit që ka përcaktuar. Prandaj them që është specifik rasti konkret. Jo sepse nuk duam ta lidhim me kohën kur do bashkohen gjykatat, por dimë faktin që gjyqtarja do të ketë një leje të paguar nga sigurimet shoqërore.

Marçela Shehu: Atëherë i bie që do të jetë komisioni që do të verifikojë në momentin e duhur nëse ka akoma nevojë Gjirokastra apo jo? Alban, këtë po...?

Alban Toro: Patjetër! (Ripërsëritet).

Ne nuk dëshirojmë që... së pari t'i drejtohemi skemës së transferimit të detyruar, por edhe nëse verifikohet ky fakt në të ardhmen për shkak se nuk do të ketë njeri nga trupa gjyqësore që do të ushtrojë detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër,

ne nuk do dëshironim që ky transferim i detyruar të vijonte tej afatit të bashkimit të dy gjykatave. Në momentin që zonja e Përmetit do të kthehet në detyrë, detyrimisht ne do marrim vendimmarrjen për ta rikthyer personin në fjalë në gjykatën mëmë, nëse do të realizohet.

Klodian Kurushi: Më fal për ndërhyrjen, dhe kjo është e thënë në projektin tonë. Për shkak të funksionalitetit, gjyqtarit në çdo kohë mund t'u ndërpritet skema e transferimit dhe do të shkojë tek gjykata e tij.

Naureda Llagami: Hedhim në votim propozimin, sepse mendoj që kemi një standard ndryshe nëse ne do të vendosim këtu datë. Pra këtu nuk vendosim datë dhe atje vendosim datë, se po Këshilli duhet të reagonte edhe atje. Këtu është problemi. Kështu që unë bashkohem me qëndrimin e Marçelës që ne e vlerësuam një herë që duhet të ishte me datë, dhe le të jetë po Këshilli më pas, duke parë edhe situatën që ndodhet në atë momente gjykata (nuk e di se si do jetë edhe ecuria e procesit të vetingut). Këshilli të vlerësojë më pas vazhdimin/përsëritjen apo jo. Kjo besoj do të jetë çështje për të gjithë gjykatat ku ka transferime.

Marçela Shehu: Vetëm se kjo, më fal Kryetare, ka një veçanti, se në rastin e Kavajës dhe në rastin e Gjykatës Administrative Durrës, bëheshe fjalë për dy gjykata që prekeshin nga riorganizimi. Ndërsa Gjykata e Gjirokastrës vetë nuk preket, ajo përthith një gjykatë tjetër. Ama ajo si gjykatë do vazhdojë të qëndrojë, pavarësisht riorganizimit të kompetencave tokësore apo ndryshimit të numrit të gjyqtarëve. Ky është dallimi midis dy rasteve që mund të jetë i pranueshëm edhe propozimi që ka sjellë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Gjithsesi, si ta vlerësojnë anëtarët. Por që, duket që rastet nuk janë identike me transferimet e mëparshme.

Naureda Llagami: Në të dy rastet Marçela, prapë do kërkohet vendimi i Këshillit, pra si tek rasti ku përthithen, si tek rasti... qëndrimi i Komisionit ka qenë që Këshilli këtu është dhe prapë do vlerësohet dhe do merret vendim për përsëritjen apo jo. Pra në të dy rastet Këshilli do investohet.

Alban Toro: Jo Naureda, sepse në rastin e dytë, nëse gjyqtarja nuk kthehet, për çdo problem shëndetësor që ajo do të ketë, derisa të verifikohet mbarimi i lejes së shtatzënisë, afati është i lidhur me afatin 1-vjeçar dhe ne nuk kemi pse investohemi për të marrë një vendim që të vazhdojë zotëria që do t'i bie rasti për të ushtruar detyrën pranë Gjirokastrës, por do të vijojë detyrën. Ne do të ndërhyjmë vetëm në momentin që zonja në fjalë, mbasi mbaron lejen, do të rikthehet në vendin e punës, atëherë në atë moment ne na del për detyrë që të investohemi dhe zotërinë që e kemi emëruar përkohësisht me transferim të detyruar ta kthejmë në gjykatën mëmë ku ka ardhur. Vetëm në atë rast na del për detyrë.

Ndërkohë që propozimi na investon dy herë, ky tjetri, pra fakti që ta lidhim me afatin e majit, sepse detyrimisht do të investohemi në rast moskthimit nga ana e gjyqtares në fjalë në detyrë, ne jemi të detyruar që zotërisë t'i rizgjatet afatet apo do të rihapim prapë për të mos e bërë të detyrueshëm procedurën e transferimit, ta fillojmë me fazën e parë (atë me pëlqim), pra do të implikojë kohë, procedurë, burime njerëzore, kur në rastin konkret oportuniteti është që të vijojë me afatin maksimal dhe në rast se përmirësohet situata, çdo gjë shkon në vendin e mëparshëm, pa asnjë lloj problemi.

Ilir Rusi: Mund të them diçka?

Naureda Llagami: Po, Ilir!

Pastaj Brikena!

Ilir Rusi: Unë gjykoj që ne nuk është se jemi marrë me krahasimin e rasteve të ndryshme që paraqesin gjykata të ndryshme sipas përkatësisë së tyre, por ne kemi ndjekur një standard, që në rastin e transferimeve, nëse ato përsëriten me pëlqim duke u vazhduar transferimi i atyre gjyqtarëve që janë, nëse shprehin pëlqimin, apo në rastin konkret ku ne po hapim një vend të ri transferimi, sepse nuk kemi aktualisht një gjyqtar të cilit t'i kërkohet përsëritja apo shprehja e vullnetit për të vazhduar transferimin. Ne po ndjekim afatet e përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave i cili bën riorganizimin e gjykatave. Ky është standardi më i thjeshtë dhe më primar për t'u ndjekur. Po ndjekim ato afate. Se çfarë do ndodhë me gjykatën në momentin kur ne kemi detyrimin që t'i

organizojmë dhe të nxjerrim aktet dhe ato të bëhen funksionale (apeli në shkurt, shkallët e para të juridiksionit të përgjithshëm në 1 maj, administrative shkallët e para në datën 1 korrik), atëherë është çështje për të gjykuar atë që ne po diskutojmë. Prandaj ne të ndjekim atë standard që, kemi transferim? – deri në këtë moment do të jetë transferimi, sepse ne e dimë deri kur do jetë rrugëtimi i gjykatave. Kështu mendoj domethënë. Pa hyrë në detaje, sepse po të hyjmë në detaje, çdo gjykatë paraqet raste specifike. Po kaluam tek emrat, përsëri paraqiten raste specifike. Ne t'i tejkalojmë emrat dhe të flasim parimisht për to, duke marrë në konsideratë një akt që është në fuqi. Jam i mendimit që transferimet... kemi edhe një klauzolë që kemi përcaktuar, që "kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në 1 vit", ne duke e përcaktuar "deri në 1 maj", nuk e kapërcejmë këtë afatin maksimal që është 1-vjeçar dhe mendoj që jemi brenda këtij afati që thotë "deri në 1 vit". Faleminderit!

Alban Toro: Atëherë, nëse më lejon, të bëj një ndërhyrje të vogël, se e dëgjoj vazhdimisht këtë...

Naureda Llagami: Alban, e kishte Brikena fjalën.

Alban Toro: Urdhëro!
Ah, okej! Më fal!
E vijoj më pas.

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë dua të bëj një analizë më afatgjatë.

Marrim rastin që gjyqtarja nuk do kthehet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër deri tani e ka përballuar me tre gjyqtarë, apo jo, e ka përballuar ngarkesën me tre gjyqtarë (dy i ka pasur në organikë dhe një ka qenë i transferuar). Në të njëjtën situatë me tre gjyqtarë do jetë deri në datën 1 maj sepse një gjyqtar do të transferohet. Mbas datës 1 maj, çfarë do të ndodhë? Do ndërpritet transferimi dhe do shkojnë dy gjyqtarë. Pra jemi përsëri në të njëjtën situatë. Nëse gjyqtarja {...} nuk do të shkojë në punë, sepse do të jetë me barrë lindje, do të mbeten tre gjyqtarë dhe këto tre gjyqtarë do të jenë vetëm për dy muaj, sepse në korrik Këshilli shpall vendet për magjistratët e rinj. Pse do të na duhet të

ndërpresim transferimin për të hapur një vend vakant? E dyta, çështjet që shkojnë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, po të shohim statistikat, janë minimaliste. Është gjykata që ndoshta ka ngarkesën shumë të vogël të çështjeve. Është një ngarkesë e tillë e cila nuk do të sjellë një rritje të menjëhershme të numrit të çështjeve të reja që shkojnë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Për këtë arsye mendoj që afati 01.05.2022 *(2023)* është një afat i arsyeshëm, jo vetëm për shkak të standardit por edhe për shkak të funksionalitetit të gjykatës, e parë kjo edhe me një analizë afatgjatë.

Faleminderit!

Alban Toro: Në lidhje me këtë sa tha Brikena, nuk mendoj që do vazhdoj prapë, sepse ndaj opinion të kundërt. Ndërkohë që, për opinionin e Ilirit, e kam dëgjuar vazhdimisht që tentohet që afatet e Këshillit të Ministrave të jenë afate deçiziv për KLGJ–në. Në opinionin tim nuk janë të tillë. Aktualisht KLGJ–ja ka bërë detyrën e vet kushtetuese, ka përcaktuar një hartë, i takon palës tjetër që ta suportojë me buxhet dhe me godina në të cilat do të përdoren për të ndërtuar, riparuar, zgjeruar gjykatat përkatëse. Nëse ky fakt nuk ndodh, nuk besoj se KLGJ–ja është e lidhur me afate, pasi gjyqtarët janë nëpunës të lartë dhe shërbëtorë të ligjit, të cilët do duan një ambient të përshtatshëm për të ushtruar detyrën. Ne nuk mund t'u themi gjyqtarëve se meqenëse qeveria na paska vendosur ca afate, por nuk na ka dhënë buxhet apo ambiente, ata janë të detyruar të futen në kotece pulash. Këtë nuk e bëj dot dhe as kam për ta bërë.

Dritan Hallunaj: Të lutem, a mund ta hedhim në votim, se të gjithë i dhanë opinionet dhe u shprehën të gjithë.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e Brikenës, lidhur me vendosjen e afatit përkatës, tek afati 1-vjeçar duke e lidhur me afatin kur harta gjyqësore hyn në fuqi për gjykatat e rrethit gjyqësor, që është 1 prill 2023. Jemi dakord me propozimin?

Brikena Ukperaj: 1 maj.

Ilir Rusi: 1 maj. (Ripërsëritet)

Dakord me propozimin e zonjës Ukperaj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Fatmira Luli: Pro, për shkak të qëndrimit të mëparshëm që kemi mbajtur.

Marçela Shehu: Kundër. Unë në fakt thashë që për sa i përket standardit do të më bënte sens që të ruanim të njëjtin standard lidhur me afatin që do të ndiqnim në rastin e procedurave të transferimit, por duke dëgjuar analizën dhe arsyet që parashtron Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si dhe duke pasur në konsideratë që Gjirokastra në fakt nuk është një gjykatë që preket drejtpërsëdrejti nga harta gjyqësore, për shkak se ajo në fakt përthith gjyqtarë dhe nuk është se vetë transferohet në një gjykatë tjetër, vlerësoj se duhet të votoj kundër, për t'i dhënë hapësirë pastaj Komisionit të Karrierës që në momentin e caktuar, pra në momentin e riorganizimit, pra në 1 maj 2023, pas bashkimit të gjyqtarëve dhe fillimit të funksionimit të gjykatës së re të Gjirokastrës (nëse do ta quanim kështu), të vlerësonte edhe ndërprerjen ose jo të periudhës së transferimit për gjyqtarin që mund të transferohet.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

(6 vota pro dhe 5 vota kundër.)

Sa vota ishin pro dhe kundër?

Ilir Rusi: 6 vota ishin pro dhe 5 kundër.

Naureda Llagami: Faleminderit Ilir!

Atëherë, miratohet propozimi i bërë nga zonja Ukperaj!

Kalojmë në votimin në tërësi të aktit.

Ilir Rusi: Dakord me tërësinë e aktit, me ndryshimin përkatës të cilin sapo e votuam, në lidhje me kohëzgjatjen e transferimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro, me kundërshtimin e pikës që diskutuam.

Ridvan Hado: Dakord, me rezervën që shpreha më lart.

Alban Toro: Pjesërisht dakord. Kundër vetëm për pjesën e afatit.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord në tërësi, me kundërshtimin e pikës 7 të projektvendimit që i referohet afatit, datës 01.05.2022 *(2023)*.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm, për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm është deri më datë 17.10.2022. 7.

Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në 01.05.2022 *(2023)*. Ky transferim mund të përsëritet.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 10.10.2022)

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}", (relatore znj. Marçela Shehu).[1]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

[1] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta sipas rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj.

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}", (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Sikurse edhe jeni në dijeni sepse ju është përcjellë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}", shoqëruar me relacionin bashkëlidhur.

Unë nuk do të zgjatem në detaje sepse më gjatë, lidhur me kandidimin e z. {...} ne jemi ndalur në paraqitjen e projektvendimit të mëparshëm për renditjen e kandidatëve, të cilët kishin kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, dhe bëhej fjalë për një pozicion në Gjykatën e Apelit Korçë, ku rezultonte si kandidat i vetëm z. {...}, dhe për këtë arsye në renditjen që iu bë kandidatit z. {...}, i cili pas verifikimit nga ana e Këshillit përmbushte të gjitha kriteret ligjore për kandidimin e tij dhe pas vlerësimit profesional nga Komisioni përkatës me vendim të Këshillit... pra duke qenë se në atë projektvendim dhe me vendimin e Këshillit z. {...} u rendit i pari dhe

i vetmi, me vendimin nr. 380, datë 19.09.2022 të Këshillit, dhe pas komunikimit që iu bë të vendimit për kandidatin dhe pasi ai nuk paraqiti ankim, duke shprehur dakordësinë e tij lidhur me vendimin e renditjes nga Këshilli, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se jemi në kushtet për paraqitjen e projektvendimit përkatës "Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}".

Pika e parë e projektvendimit bën fjalë për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se efektet juridike të tij të fillojnë më datë 15.10.2022, duke sjellë këtu në vëmendje të Këshillit se sipas vendimit nr. 414, datë 29.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, efektet juridike për caktimin në skemën e delegimit të z. {...} mbarojnë me datë 14.10.2022. Pra zoti {...}, që nga data 14.10.2022 (i vitit të kaluar 2021), ka qenë i caktuar në skemën e delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, ku aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Sjellim në vëmendje gjithashtu edhe ngarkesën që zoti {...} ka në gjykatën ku është caktuar nga ana e Këshillit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta. Sipas informacionit të marrë nga Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, z. {...} ka aktualisht në shqyrtim e sipër 3 (tre) çështje gjyqësore civile, të cilat nuk janë në fazë të avancuar të shqyrtimit gjyqësor por janë të pezulluara. Sipas informacionit të marrë prej Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimit të Organizuar, z. {...} ka aktualisht në shqyrtim 1 (një) çështje gjyqësore. Sipas informacioneve të marra prej Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Gjirokastër, z. {...} ka aktualisht në shqyrtim e sipër 4 (katër) çështje gjyqësore.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Ky është edhe projektvendimi që i paraqitet për shqyrtim mbledhjes plenare.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatores?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Meqë nuk ka diskutime, se prisja që të kishte edhe ndonjë diskutim, pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Bashkohem me parafolësit.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës e Apelit Korçë, z. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 15.10.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 10.10.2022)

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022", (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj.

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022", (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Relacioni dhe projektvendimi që i paraqitet sot për shqyrtim mbledhjes plenare është i kondicionuar nga një ndryshim që ka ndodhur në listën e gjyqtarëve udhëheqës si dhe të gjyqtarëve të caktuar si mentor në periudhën e dytë dhe të tretë të vitit të tretë të kandidatëve për gjyqtarë, në kushtet kur për mentorin gjyqtarin z. {...}, Këshilli ka marrë vendimin e deklarimit të mbarimit të statusit në datën 31.10.2022. Nga ky moment dhe në vazhdim gjyqtari nuk do të ushtrojë më detyrën e gjyqtarit dhe për pasojë nuk mund të ushtrojë as detyrën e mentorit të caktuar për kandidatët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës.

Në këto kushte, ka lindur e domosdoshme që paraprakisht Këshilli të marrë një vendim për ndryshimin dhe caktimin e një mentori të ri, duke qenë se data 1 nëntor 2023

e në vijim, për dy periudha katërmujore, përkon me fillimin e një mentorimi të ri për një grup të caktuar gjyqtarësh, sikundër Këshilli ka disponuar me vendimet e mëparshme.

Sipas listës së miratuar të gjyqtarëve udhëheqës për vitin akademik 2022-2023 të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (seksioni penal), rezulton se tre prej tyre tashmë janë të angazhuar, duke u caktuar pranë tyre nga dy kandidatë për magjistratë, për shkak se për vitin akademik 2022-2023 numri i kandidatëve është më i lartë se numri i gjyqtarëve udhëheqës që ushtrojnë funksionin në seksionin penal të kësaj gjykate.

Në këto kushte, zëvendësimi i gjyqtarit udhëheqës {...} në dy sesionet 4-mujore të praktikës profesionale, nëntor 2022 – shkurt 2023 dhe mars 2023 - qershor 2023, dikton nevojën e angazhimit të gjyqtarëve me caktimin pranë tyre të 2 kandidatëve, në sesionet në të cilat do të kryhet zëvendësimi. Në caktimin e gjyqtarëve pranë të cilëve do të kryejnë stazhin profesional kandidatët e caktuar më herët pranë gjyqtarit {...}, Komisioni propozon zëvendësimin me gjyqtaren {...} në sesionin e dytë dhe gjyqtaren {...} në sesionin e tretë, duke konsideruar faktin se (i) të dy gjyqtaret janë pjesë e trupës së magjistratëve udhëheqës të miratuar me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, (ii) ushtrojnë funksionin në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe (iii) rezulton të jenë caktuar gjyqtarë udhëheqës për të tre sesionet 4-mujore të vitit akademik 2022-2023, duke u caktuar pranë tyre, në sesionin respektiv, vetëm nga një kandidat për magjistrat.

Për këto arsye, Komisioni propozon se ka vend për zëvendësimin e gjyqtarit {...} me gjyqtaren {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2022 – shkurt 2023) dhe gjyqtaren {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars 2023-qershor 2023).

Angazhimi i gjyqtarëve si më sipër duke caktuar pranë tyre nga 2 kandidatë për gjyqtar është i kushtëzuar nga fakti që në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën kryejnë praktikën profesionale 40 (dyzet) kandidatë për gjyqtarë, në tre periudha 4-mujore, ushtrojnë detyrën dhe njëkohësisht janë të përfshirë në trupën e magjistratëve udhëheqës vetëm 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar ndryshimi

pjesërisht i vendimit nr. 252, datë 07.07.2022, “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023”, të ndryshuar me vendimin nr. 357, datë 27.07.2022 dhe vendimin nr. 370, datë 13.09.2022, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarët e sipërcituar për periudhat e sipërcituara katërmujore.

Në pikën 2 parashikohet njoftimi i këtij vendimi Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në përfundim është parashikuar edhe momenti i hyrjes në fuqi të këtij projektvendimi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga kolegët, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me: (i) gjyqtarin udhëheqës

znj. {...} në sesionin e dytë 4-mujor nëntor 2022 – shkurt 2023 dhe (ii) gjyqtarin udhëheqës znj. {...} në sesionin e tretë 4-mujor mars 2023 - qershor 2023.

2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. Spahiu dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 10.10.2022)

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).[2]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

[2] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Paola Ndroqi, Përfaqësuese e Universitetit "Epoka".

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Edmond Hoxhaj.

6. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Gjyqtarja {...} është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 (periudhë trevjeçare), si pjesë e gjyqtarëve të miratuar në programin e vlerësimit të vitit 2021.

Bashkë me projektraportin e vlerësimit, ju është njoftuar edhe raporti analitik në të cilin janë shpjeguar dhe analizuar në mënyrë analitike të gjitha të dhënat e burimeve të vlerësimit. Aktet e vlerësimit i janë njoftuar gjyqtares dhe brenda afatit 2-javor prej saj nuk janë paraqitur kundërshtime, nuk janë paraqitur prova të reja dhe nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

Për pasojë, po ndalem thjesht në konkluzionet e mia si vlerësuese për çdo nga treguesit e katër kritereve të vlerësimit.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, për sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, ka rezultuar në tërësi, se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilat paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtares është vlerësuar shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit të “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, nga tërësia e burimeve, sikundër përshkruhet në raportin analitik, ka rezultuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistonte dhe duke zbërthyer në elementët përbërë të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, përpara aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes konkrete. Rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete. Aftësia e gjyqtares shumë e lartë, pikëzimi 25 pikë.

Për sa i përket “Qartësisë, konçizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, nga tërësia e burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme

arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i kushtuar rëndësi dhe peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Është vlerësuar shkalla e aftësisë shumë e lartë. Pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit të "Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit", evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Shkalla e aftësisë shumë e lartë. Pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të parë që është "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik", i cili ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, dhe krijon një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë aplikim në rastin konkret. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve prapësimeve të palëve për çështje të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Shkalla e aftësisë shumë e lartë, 25 pikë.

Për kriterin e parë "Aftësitë profesionale të gjyqtares" propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket "Aftësive organizative të gjyqtares", ka rezultuar nga raporti analitik se nga tërësia e çështjeve që gjyqtarja ka shqyrtuar, afërsisht janë 2000 çështje për periudhën 3-vjeçare, 475 prej tyre kanë qenë çështje me afat ligjor, nga të cilat 56 çështje kanë rezultuar të tejkaluara tej afatit, e cila në përqindje përkthehet në 11.78%. Pavarësisht kësaj, duke marrë parasysh se vlerësuesi, në analizën e të dhënave nuk bazohet vetëm në analizën matematikore, por edhe atë logjike, referuar edhe të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e

gjyqtares, kam vlerësuar se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes 11.78 të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit dhe që në rastin konkret përkon me pikëzimin maksimal. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Tejkalimi i afatit në fakt është vetëm me 1.78%. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë (Respektimi i afateve ligjore).

Për sa i përket treguesit tjetër "Plotësimit të standardeve minimale kohore", në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, ka rezultuar se nga 1506 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 186 prej tyre ose 12.35% janë gjykuar jashtë standardit minimal duke e kaluar këtë standard vetëm 2.35%. Pavarësisht kësaj, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë parasysh edhe kohën relativisht të shkurtër të tejkalimit të standardit në disa prej çështjeve të analizuara (tejkalime nga 3 ditë deri në 5 ditë) i cili sipas të dhënave statistikore dhe atyre logjike duhet të konsiderohet i pakonsiderueshëm për të afektuar aftësinë e gjyqtares, kam vlerësuar se gjyqtarja duhet të pikëzohet, marrë parasysh edhe ngarkesën tepër të lartë në punë që ka përballuar, me një shkallë më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara, duke e konsideruar aftësinë e gjyqtares brenda nivelit 0-10%, dhe pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket "Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", në Metodologjinë e Pikëzimit, për këtë tregues parashikohet se për të bërë pikëzimin e tij, të dhënat statistikore analizohen me kujdes sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 8 (tetë) kategori çështjesh, vetëm për 1 (një) prej tyre koha mesatare e tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtarja me një analizë matematikore duhej të pikëzohej me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e gjatë se standardi vetëm për 1 (një) nga 8 (tetë) kategoritë e çështjeve, duke u tejkaluar koha mesatare me 5.6 muaj për kategorinë "Penale-kundërvajtje". Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për periudhën e vlerësimit 1981 çështje, nga

të cilat 790 çështje me palë kundërshtare (263 në vitin 2017, 219 në vitin 2018 dhe 308 çështje me palë kundërshtare në vitin 2019), ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje në vit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare (duke qenë se ka qenë gjyqtare në seksionin civil), duke tejkaluar këtë standard me 119% në vitin 2017, 82.5% në vitin 2018 dhe 156.6% në vitin 2019. Në kushtet kur standardi sasior i punës është dukshëm më i lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me vendimin e KLD-së, gjyqtarja për këtë tregues duhet të vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket "Rendimentit të përfundimit të çështjeve", i matur si raport midis çështjeve të përfunduara dhe atyre të caktuara, ai ka rezultuar në masën 96.39%, e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë. Por duke bërë një analizë logjike të të dhënave burimore dhe duke vlerësuar edhe ngarkesën në punë të gjyqtares, rezulton se ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit me 119% si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare që janë 1191 çështje, çka ka rritur dukshëm ngarkesën e saj në punë, vlerësoj se është rasti për të aplikuar një shkallë më të lartë pikëzimi sesa ai që rezulton nga llogaritja matematikore, duke pikëzuar gjyqtaren në këtë tregues me 10 pikë.

Për sa i përket "Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar", referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë "Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve", pasi vetëm për një nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë kaluar me 1 ditë (tejkalim i papërfillshëm), ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsyetimit rezulton më i shkurtër se afati procedural. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin e gjyqtares me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit të "Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive", ka rezultuar se numri i seancave në të gjitha çështjet e analizuara është 2 seanca, marrë parasysh që të gjitha çështjet pothuajse janë shqyrtuar pas hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Civile me ndryshimet përkatëse. Në çdo rast gjyqtarja ka kryer me efektivitet të gjitha veprimet procedurale si në fazën paragjykimore ashtu edhe në fazën gjykimore dhe ka shmangur zhvillimin e seancave joproduktive duke planifikuar

dhe zhvilluar në kohë dhe me efektivitet ato. Për këtë arsye pikëzimi propozohet të jetë 15 pikë.

Për sa i përket "Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin gjyqësor", në tërësi referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efiçencë veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efiçencë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse, çka është reflektuar edhe në treguesin e sasisë dhe kohëzgjatjes së gjykimeve, duke u pikëzuar kështu me 20 pikë.

Për sa i përket "Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes", "Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes", përsëri vlerësohet shkalla e aftësisë së gjyqtares shumë e lartë, duke u pikëzuar me 5 pikë për treguesin e parë dhe me 10 pikë për treguesin e dytë. Referuar burimeve të vlerësimit, dosjet rezultojnë të jenë renditur në mënyrë të tillë që mundet të shfrytëzohen me lehtësi për lexuesin dhe nga ana tjetër nuk konstatohen akte që nuk i përkasin apo që duhet t'i përkisnin çështjes konkrete. Për këtë arsye aftësia e gjyqtares edhe për këtë tregues pikëzohet me 10 pikë.

Përfundimisht, për treguesin e "Aftësive organizative të gjyqtares", propozimi për nivelin e vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 100.

Për sa i përket kriterit të tretë "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale", lidhur me treguesin e parë "Etika në punë", "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion", nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares u konstatuan këto të dhëna: Referuar informacionit të përcjellë nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë rezulton që për të gjithë periudhën trevjeçare të punës së gjyqtares, ka pasur vetëm 1 (një) ankesë, për të cilën Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.757/1 prot., datë 15.04.2022 ka vendosur arkivimin e saj, pas shqyrtimit fillestar. Arsyetimi i vendimit të ILD-së gjendet në relacion. Është konstatuar që pretendimet e ngritura mund të zgjidhen vetëm në rrugë gjyqësore dhe nuk ka të dhëna që mund të afektojnë etikën në punë të gjyqtares. Nga ana tjetër, për këtë periudhë nuk ka pasur masa disiplinore nga ana e gjyqtares. Edhe kryetari i gjykatës në formularin e

integruar të vlerësimit (zëvendëskryetari i gjykatës) i ka vlerësuar shumë të larta aftësinë e gjyqtares në drejtim të angazhimit të përgjegjshmërisë në funksion, i cili është edhe një nga burimet e rëndësishme të vlerësimit për këtë tregues. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 35 pikë për sa i përket këtij treguesi.

Për sa i përket "Integritetit të gjyqtares", janë analizuar në drejtim të këtij treguesi të "Shmangies së shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti", të dhënat e ILD-së lidhur me rezultatet e verifikimit të ankesave dhe mungesës së masave disiplinore, njëkohësisht janë analizuar edhe të dhënat e përcjella në raportin e ILDKPI-së. Ka rezultuar se gjyqtarja ka dorëzuar deklaratën brenda afateve dhe ajo është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe nuk është verifikuar asnjë nga rastet e konfliktit të interesit. Në këto kushte, edhe në kushtet kur edhe kryetari i gjykatës ka vlerësuar shumë të lartë aftësinë e gjyqtares në këtë tregues, për shkak të parimit të prezumimit dhe në mungesë të të dhënave që mund të afektojnë këtë tregues, është propozuar aftësia shumë e lartë dhe pikëzimi me 40 pikë.

Për sa i përket "Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Është pikëzuar me 10 pikë.

"Për sa i përket numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares", ka rezultuar që janë bërë 9 kërkesa, nga të cilat 2 rezultojnë të jenë pranuar, por këto nuk kanë qenë kërkesa që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit dhe për këtë arsye numri vlerësohet të konsiderohet i pakonsiderueshëm sipas metodologjisë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket propozimit për nivelin përfundimtar të vlerësimit për kriterin e tretë "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale", propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me kriterin e katërt "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" gjyqtarja vlerësohet në shkallë shumë të lartë aftësie dhe pikët maksimale sipas metodologjisë për komunikimin e qartë dhe transparent me palët dhe administratën, për

respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale si dhe për bashkëpunimin e saj me kolegët duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta si dhe komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore.

Për sa i përket "Gatishmërisë së gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", lidhur me "Pjesëmarrjen e gjyqtares në formimin vazhdues", ka rezultuar se ajo ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese kryesisht për tema të së drejtës civile dhe penale, gjithsej 17 aktivitete, të zhvilluara prej 32.5 ditë, 28.5 ditë plus katër ditë trajnim kanë qenë jashtë vendit, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve nga 15-120 ditë për të gjithë periudhën trevjeçare, prandaj pikëzohet me 20 pikë.

Për sa i përket "Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin..." nuk ka pasur të dhëna, pikëzimi është 3 pikë.

Për sa i përket "Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata", ka pasur prova që reflektojnë angazhimin e gjyqtares në kuadër të këtij treguesi. Konkretisht ka rezultuar që gjatë vitit akademik 2016-2017 gjyqtarja ka qenë e angazhuar si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë, Kolegji Universitar Privat "Pavarësia Vlorë", në programin e studimeve master, simetri i II, në lëndën "E drejtë administrative e avancuar". Duke qenë se ka pasur të dhëna, pikëzimi për këtë tregues propozohet të jetë 5 pikë.

Nuk ka pasur të dhëna lidhur me publikimet ligjore akademike. Prandaj për këtë tregues është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e katërt dhe të fundit të "Aftësive personale dhe angazhimit profesional" propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 93.

Lidhur me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit, përfundimisht për kriterin e parë "Aftësitë personale të gjyqtares" niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", 100 pikë.

Për "Aftësitë organizative të gjyqtares", niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", 100 pikë.

Për "Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale", niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional", vlerësimi "Shkëlqyeshëm",

93.

Në total, niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", 393 pikë.

Janë përpiluar dhe propozimet dhe rekomandimet që gjyqtarja duhet të ketë parasysh në vijimin e veprimtarisë së saj gjyqësore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Brikena, faleminderit!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim, sugjerim mbi projektraportin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm". (393 pikë).

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të

Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95, pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor